

## SHENIMET SHPJEGJEGJISE

### Scanim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2 i përmirësuar. Potesimi i te dhenave të kësaj pjesë duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarde të përcaktuara në SKK 2 të përmirësuar. Rradha e dhenies së shpjegimeve duhet të jete :

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabel
- b) Shënime që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

### A I Informacion i përgjithshëm

Kuadri ligjor: Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

Kuadri kontabel i aplikuar : Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2;)

Baza e pergatitjes se PF : Mbi bazen e konceptit te materialitetit.(SSK 1, 1-3)

Parimet baze per pergatitjen e Pasqyrave Financiare : (SKK 1; 40 - 90)

1. Parimi i njesise ekonomike: mban ne llogarite e saj aktivet, detyrimet dhe transakcionet ekonomike te veta.
2. Parimi i vijimesise: veprimtaria ekonomike e njesise: sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit te saj.
3. Kompensimi: midis nje aktiviteti dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
4. Kuptushmeria e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te qene te qarta dhe te kuptushme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
5. Materialiteti eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
6. Besushmeria per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhteme :
  - Parimin e paraqitjes me besnikeri
  - Parimin e perparesise se pëmbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
  - Parimin e përneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
  - Parimin e maturise pa optimizem te teperuar, pa nen e mbi vleresim te qellimshem
  - Parimin e pletesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
  - Parimin e qendrueshmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
  - Parimin e krahasueshmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

### A II Politikat kontabel

Per percaktimin e koston se inventareve eshte zgjedhur metoda "FIFO" ( hyrje e pare, dalje e pare.(SKK 4; )

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe pleteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto. (SKK 5; )

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua, koston e huamarrjes (dhe interesat) eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivitetit per periudhen e investimit.(SKK 5; )

Per vleresimi i mepaseshem i AAM eshte zgjedhur modeli i koston duke i paraqitur ne bilanc me koston minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5; )

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5;) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit te A Agj.M metodet e amortizimit mbi bazen e vlefes se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdorur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

- Per ndertesat me 5 % te vlefes se mbetur.
- Komputera e sisteme informacioni me 25 % te vlefes se mbetur
- Te gjitha AAM te tjera me 20 % te vlefes se mbetur

### C Shënime të tjera shpjeguese

Ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat behen rregullime apo ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat nuk behen rregullime nuk ka.

Gabime materiale te ndodhura ne periudhat kontabel te mepareshme te konstatuara gjate periudhes raportuese dhe qe korigjim nuk ka.

